

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RE GREEN” sh.p.k.

Tiranë, më 10.01.2022

KREU I: THEMELIMI, EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA

NENI 1: ORTAKËT THEMELUES

1.1 Sot, me datë 10.01.2022, krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “RE GREEN” sh.p.k. (më poshtë e në vijim e quajtur “Shoqëria”).

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:



- **zj. Ermelinda Baço**, shtetase shqiptare, lindur më 31.08.1981 në Tiranë, banuese në Tiranë, me Nr. Personal I15831197B, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar,
 - **z. Rajmond Pavaci**, shtetas shqiptar, lindur më 26.08.1972 në Shkodër, banues në Tiranë, me Nr. Personal H20826087W, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
- të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë krijojnë shoqërinë si vijon.

NENI 2: EMËRTIMI

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “RE GREEN” sh.p.k. (më poshtë e në vijim e quajtur “Shoqëria”).

NENI 3: FORMA LIGJORE

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me ligjislacionin tregtar në Shqipëri.



NENI 4: SELIA

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Unaza e Re, Rruga "Teodor Keko", Tiranë.
- 4.2 Shoqëria mund të hapë filiale apo zyra përfaqësie kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 4.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

KREU II: BAZA LIGJORE, OBJEKTI, AFATI, VULA


NENI 5: BAZA LIGJORE

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera dhe nënakte ligjore në fuqi.
- 5.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të jenë të aplikueshme dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 5.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe / ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 6: OBJEKTI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin me objekt:

- 6.1 Ndërmjetësim në shitblerje dhe dhënie me qira pronash të patundshme. Konsulenca të ndryshme lidhur me pronat, për shitjen, blerjen, dhënien apo marrjen me qira si dhe rivlerësimin e tyre, në Shqipëri apo jashtë saj.
- 6.2 Agjensi Imobiliare. Menaxhim pronash, menaxhim të qirave; Arredime të brendshme shtëpie.
- 6.3 Konsulencë tregtare dhe investimi. Plane Biznesi. Plane Marketingu apo shërbime të tjera të ngjashme.
- 6.4 Çdo shërbim tjetër në lidhje me tregun imobiliar në të gjitha nivelet e shërbimit. Operacione tregtare në komisioneri.
- 6.5 Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë veprimtari të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me veprimtarinë e saj përmes një marrëveshjeje franchising.
- 6.6 Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër që është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.



NENI 7: AFATI

- 7.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me rregjistrimin e saj në Rregjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.
- 7.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

NENI 8: VULA

- 8.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj, me tekst kryesor emrin e shoqërisë "RE GREEN" sh.p.k. Vula do të përdoret nga ortakët e shoqërisë.
- 8.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e ligjislacionit shqiptar.
- 8.3 Të gjitha dokumentat e shoqërisë duhet të përmbajnë vulën e saj.


KREU III: KAPITALI THEMELTAR, TRANSFERIMI I KUOTAVE, KUFIZIMET

NENI 9: KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 Lekë.
- 9.2 Kapitali themeltar përbëhet nga dy (2) kuota.
- 9.3 Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët në masën si më poshtë:
- zj. Ermelinda Baço zotëron një (1) kuotë me vlerë nominale 500 (pesëqind) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - z. Rajmond Pavaci zotëron një (1) kuotë me vlerë nominale 500 (pesëqind) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.
- 9.5 Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10: TRANSFERIMI I KUOTAVE, KUFIZIMET

- 10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.
- 10.2 Vendosja e çfarëdoj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treat do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.



KREU IV: ASAMBLEJA E ORTAKËVE, ADMINISTRIMI

NENI 11: ASAMBLEJA E ORTAKËVE

11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet më poshtë:

- përcaktimin e politikave tregtare dhe objektivave të shoqërisë;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave të shoqërisë dhe të raporteve financiare;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- miratimin e shkrirjes / bashkimit me shoqëri të tjera;
- ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- ndryshimin e selisë dhe/ose emërimit të shoqërisë;
- emërtimin e ekspertëve kontabël të autorizuar nëse është e nevojshme;
- rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, në çdo rast në përpjestim të drejtë me pjesmarrjen që zotëron secili në kapitalin e shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treat;
- ristrukturimin ose prishjen e shoqërisë;
- emërtimin e administratorit ose ndërrimin e administratorit të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit të administratorit;
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve;
- transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga statute dhe/ose nga ligji.

NENI 12: ADMINISTRIMI

12.1 Përfaqësimi i shoqërisë do të kryhet nga secili prej ortakëve dhe këtu përfshihen edhe kompetenca ushtruese, dhe jo vetëm, si më poshtë:

- përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, personalisht ose të dy bashkë; dhe këtu përfshihet (por jo kufizuar) në përfaqësimin e shoqërisë përpara institucioneve tatimore, bankave të nivelit të dytë si dhe të kryejnë (veç e veç ose të dy bashkë) çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- pregatitja e dokumentave në emër të shoqërisë;
- hartimi dhe mbajtja e kontabilitetit;
- të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër, me kohë të plotë ose të pjesshme, që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë;

12.2 Administrator i shoqërisë emërohet:

zj. **Eljana Brahja**, shtetase shqiptare, lindur më 17.04.1983 në Tiranë, banuese në Tiranë, me Nr. Personal I35417039E.

- Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Administratori është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë;

12.3 Mandati i Administratorit është me afat 5-vjeçar.

KREU V: VITI FINANCIAR, BILANCI E KONTABILITETI, TË ARDHURAT, DIVIDENTI

NENI 13: VITI FINANCIAR

- 13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar i shoqërisë fillon nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 14: BILANCI, KONTABILITETI

- 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të pregatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit deri në fund të muajit Mars të çdo viti pasardhës.
- 14.2 Kontabiliteti mbahen në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin përkatës brenda vitit.
- 14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.


NENI 15: TË ARDHURAT, DIVIDENTI

- 15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të veprimtarisë së saj në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve e shlyerjes së detyrimeve të tjera, mund të ndahen tek ortakët.
- 15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar nga ortakët dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

KREU VI: LIKUJDIMI, MOSMARRËVESHJET, KLAUZOLA MBYLLËSE

NENI 16: LIKUJDIMI

- 16.1 Likujdimi i shoqërisë si dhe emërimi i likujdatorit/likujdatorëve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm.



NENI 17: MOSMARRËVESHJET


17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim të ndërsjelltë do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 18: KLAUZOLË MBYLLËSE

18.1 Ky Statut hartohet në tre (3) ekzemplarë në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore.


ADMINISTRATORI

Zj. Eljana Brahja

Eljana Brahja


ORTAKËT

zj. Ermelinda Baço

Ermelinda Baço


z. Rajmond Pavaci

Rajmond Pavaci
